


Të diplomuarit nga **arsimi profesional** 2019-2020

Gjurmimi në nivel kombëtar



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



TË DIPLOMUARIT NGA ARSIMI PROFESIONAL 2019-2020: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Ky publikim është hartuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J).

Autorë (në rend alfabetik):

Erka Çaro PhD
Aleka Papa
Eltjana Plaku

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

AFTËSI PËR PUNË S4J

 **Rruga Skënderbej, Vila nr. 49**
Tirana, Albania, P.O. Box 2891

 **+355 42 231 850**

 **al.info@swisscontact.org**

 **www.skillsforjobs.al**

/ Lista me tabelat

Tabela 1 Gjurmimi kombëtar vs. gjurmimi në nivel ofruesi

Tabela 2 Parashikimi i optimizimit në 4 rajone sipas shkollave

Tabela 3 Shpërndarja sipas gjinisë

Tabela 4 Shpërndarja sipas drejtimeve mësimore

Tabela 5 Shpërndarja sipas rajoneve

Tabela 6 Statusi i punësimit sipas gjinisë

Tabela 7 Cila është situata jote aktuale e punësimit (sipas rajoneve)?

Tabela 8 Kur e ke filluar punën tënde të parë pas mbarimit të shkollës? (si % e të diplomuarve që janë të punësuar)

Tabela 9 Sa kohë pas diplomimit t'u desh që të hapje biznesin tënd?

Tabela 10 Si e gjete punën tënde të parë?

Tabela 11 Sa kohë ke që punon te puna aktuale?

Tabela 12 Sa punë ke ndërruar që nga diplomimi/puna jote e parë?

Tabela 13 Cila ishte arsyeja kryesore që u largove nga puna jote e fundit?

Tabela 14 Sa është numri i punonjësve në kompaninë ku punon?

Tabela 15 Çfarë lloj kontrate pune ke me punëdhënësin?

Tabela 16 A të paguhen sigurimet?

Tabela 17 Sa i/e sigurt (stabilizuar) ndihesh në punën tënde aktuale?

Tabela 18 Niveli i pagave (net)

Tabela 19 A lidhet puna që bën me atë që ke studiuar?

Tabela 20 Nëse jo, pse?

Tabela 21 Në ç'shallë i përdor njohuritë që ke fituar gjatë studimeve të tua në punën tënde aktuale?

Tabela 22 Në ç'shallë është pozicioni yt aktual i lidhur me studimet e tua?

Tabela 23 Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas gjinisë

Tabela 24 Si po kërkon për punë?

Tabela 25 Cila është arsyeja që nuk po kërkon për punë?

Tabela 26 Arsyet kryesore së përse nuk po kërkon për punë sipas rajoneve

Tabela 27 Nëse do kishe mundësi a do të zgjidhje të njëjtën shkollë?

Tabela 28 Nëse do kishe mundësi a do të zgjidhje të njëjtën degë/drejtim?

Tabela 29 Fushat që kanë nevojë për 'shumë' përmirësim

Tabela 30 Fushat që kanë nevojë për 'shumë' përmirësim

/ Lista me grafikët

Figura 1 Cila është situata jote aktuale e punësimit?

Figura 2 Statusi i punësimit sipas drejtimit

Figura 3 % e të diplomuarve të punësuar që kanë gjetur punë deri në 3 muaj pas diplomimit

Figura 4 Angazhimi në kohë

Figura 5 Sektori ekonomik sipas NACE Rev.2

Figura 6 A të paguhen sigurimet (sipas drejtimeve) - % që deklarojnë Jo?

Figura 7 Sa i/e sigurt (stabilizuar) ndihesh në punën tënde aktuale (sipas drejtimit)

Figura 8 Niveli i pagave sipas gjinisë

Figura 9 Niveli i pagave sipas drejtimeve

Figura 10 Lidhja e punës me studimet sipas gjinisë

Figura 11 Lidhja e punës me studimet sipas drejtimit (% Po)

Figura 12 Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas institucioneve arsimore dhe rajoneve

Figura 13 Institucioni arsimor

Figura 14 Lidhja e fushës së studimeve me studimet e mëparshme

Figura 15 Lidhja e fushës së studimeve/trajnimeve me studimet e mëparshme sipas rajoneve

Figura 17 Të diplomuar të papunë (në kërkim të një pune) sipas rajoneve

Figura 16 Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnitimit

Figura 18 A je regjistruar si punëkërkues i papunë te zyra e punës?

Figura 19 Si po të ndihmon Zyra e punës për të gjetur një punë?

Figura 20 Pse nuk je regjistruar në zyrën e punës?

Figura 21 A ke qenë ndonjëherë i punësuar që nga koha e diplomimit/mbarimit të shkollës?

Figura 22 A ke qenë ndonjëherë i punësuar që nga koha e diplomimit/mbarimit të shkollës (sipas rajoneve)?

Figura 23 Kur e ke filluar punën tënde të parë pas diplomimit?

Figura 24 Si e gjete punën tënde të parë?

Figura 25 Kur je larguar nga puna jote e fundit?

Figura 26 Cila ishte arsyeja kryesore që u largove nga puna jote e fundit?

Figura 27 Arsyet se përse nuk po kërkon për punë

Figura 28 Nëse do kishe mundësi a do të zgjidhje të njëjtën shkollë (sipas gjinisë)

Figura 29 Nëse do kishe mundësi a do të zgjidhje të njëjtën degë/drejtim ('Po' sipas drejtimeve)

Figura 30 Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%)

/ Akronimet

AFP

└ Arsimi dhe Formimi Profesional

AKPA

└ Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

IoAFP

└ Institucionet Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional

S4J


└ Projekti 'Aftësi për Punë'

SHMT

└ Shërbime Mjetesh Transporti

TIK

└ Teknologji Informacioni dhe Komunikimi





/ PËRMBAJTJA

fq.8

Përmbledhje Ekzekutive

fq. 10

HYRJE

fq. 12

METODOLOGJIA

12/ Qasja metodologjike

12/ Instrumenti i studimit - pyetësi

13/ Analizimi i të dhënave

14/ Kufizimet metodologjike

fq. 15

PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË

fq. 17

REZULTATET

17/ Situata e punësimit e të diplomuarve

18/ Situata aktuale e punësimit

fq. 22

TË DIPLOMUARIT E PUNËSUAR

22/ Tranzicioni drejt tregut të punës - koha e gjetjes së punës së parë

23/ Tranzicioni drejt tregut të punës - mënyra e gjetjes së punës së parë

24/ Integrimi në tregun e punës - karakteristikat kryesore në punë aktuale

29/ Integrimi në tregun e punës - të ardhurat

31/ Integrimi në tregun e punës - relevanca e arsimit

fq.34

TË DIPLOMUARIT QË PO VAZHDOJNË KUALIFIKIME TË MËTEJSHME

34/ Institucioni Arsimor në të cilin vazhdojnë studimet të diplomuarit

36/ Lidhja mes fushës së studimeve me studimet e mëparshme

37/ Arsytet kryesore të ndjekjes së studimeve/ trajnimeve

fq.37

TË DIPLOMUARIT PA PUNË

38/ Të kërkuarit për punë

39/ Marrëdhënia me zyrat e punës

40/ Të diplomuarit e papunë në kërkim të një pune që kanë qenë të punësuar më parë

42/ Të diplomuar joaktivë

fq.44

VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË DIPLOMUARVE PËR SHKOLLËN

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

AKPA me mbështetjen e projektit Skills for Jobs (S4J) ndërmori gjurmimin në nivel kombëtar të të diplomuarve të brezit 2019-2020 nga 36 shkollat publike të arsimit profesional në 12 qarqet e Shqipërisë me qëllimin e përgjithshëm të monitorimit të treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit nga sistemi i arsimit profesional. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të në tregun e punës dhe përfaqësojnë një burim të rëndësishëm për vlerësimin dhe mbështetjen në përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së arsimit profesional me tregun e punës.

1412 të diplomuar nga 36 shkolla të arsimit profesional iu përgjigjën sondazhit të gjurmimit gjatë periudhës shkurt-prill 2021 ose 8-10 muaj pas diplomimit të tyre. Disa nga gjetjet kryesore të sondazhit janë përmbledhur më poshtë:

- 4 në 10 të diplomuar nga arsimi profesional në 2020 ose 40.2% e të diplomuarve ishin në marrëdhënie pune 8-10 muaj pas diplomimit, nga të cilët 30.9% ishin të punësuar me pagë, 4.4% ishin të vetë-punësuar, ndërsa 4.9% punonin dhe studionin në të njëjtën kohë.
- 8.8% e të diplomuarve ndiqnin kualifikime të mëtejshme si studentë apo kursantë.
- Afërsisht 30% ishin të papunë në momentin e anketës, por vetëm 22.9% ishin të papunë që po kërkonin aktivisht për punë.
- Ka dallime në shpërndarjen e statusit të punësimit sipas gjinisë. Të diplomuarit meshkuj ishin më të prirur se të diplomuarat femra për të qenë të punësuar me 43.7% e meshkujve të punësuar përkundrejt vetëm 18.1% të femrave.
- Të diplomuarit nga drejtimet me profil industrial ishin më të prirur për t'u punësuar në krahasim me drejtimet e tjera. Më shumë se gjysma e të diplomuarve të Elektroteknikës (53.3%) dhe SHMT-së (Shërbime mjetesht transporti) (52.8%) ishin tashmë të punësuar pas mbarimit të arsimit profesional. Në sektorin e Hoteleri-Turizmit, 43.6% e të diplomuarve ishin të punësuar, ndërsa 26.5% ishin studentë ose kursantë duke u kualifikuar më tej. Nga ana tjetër, të diplomuarit e Ekonomi-Biznes ishin më të prirur për të qenë ekonomikisht joaktivë dhe të ndiqnin studime apo trajnime të mëtejshme pas diplomimit krahasuar me drejtimet e tjera.
- Të diplomuarit nga arsimi profesional integrohen relativisht lehtë në tregun e punës. 60.5% e të diplomuarve të punësuar kishin gjetur punën e tyre të parë që para mbarimit të shkollës. Në total, rreth 9 në 10 të diplomuar të punësuar (89.7%) e kishin gjetur punën e tyre të parë brenda 3 muajve pas mbarimit të shkollës.
- Njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë përfaqësojnë mënyrën më të shpeshtë sesi të diplomuarit e punësuar kishin gjetur punën e tyre të parë. 58.2% e të diplomuarve kishin gjetur punë nëpërmjet njohjeve dhe lidhjeve familjare.
- Rreth 7 në 10 të diplomuar nga arsimi profesional ose 69.9% ishin të punësuar në firma apo biznese që kryenin 3 aktivitete kryesore ekonomike (sipas Klasifikimit NACE Rev.2). 28.2% ishin biznese që kryenin tregti me shumicë dhe pakicë, 22.3% aktivitete të tjera shërbimi, ndërsa 19.4% ishin biznese në sektorin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor.
- 30.3% e të diplomuarve të punësuar kishin të ardhura nga puna deri në 30,000 lekë. 85.2% e të diplomuarve në marrëdhënie pune kishin të ardhura deri në 50,000 lekë. 8.7% e të diplomuarve deklarorin të ardhura nga 50.001-60.000 lekë. 45.7% e femrave rezultojnë me një pagë nën 30.000 lekë në krahasim me 29.2% e meshkujve. Të diplomuarit në drejtimet Mekanikë dhe TIK ishin më të prirur për të pasur të ardhura në intervalet me paga më të larta.

- Pjesa më e madhe e të diplomuarve në marrëdhënie pune ndiheshin të sigurt ose shumë të sigurt (67.7%) në punën e tyre aktuale, ndërsa 24.6% kishin një perceptim neutral.
- Pak më shumë se gjysma e të diplomuarve të punësuar ose 52.7% e të diplomuarve, punonin në një punë që lidhej me atë që kishin studiuar.
- 55% e të papunëve shprehen se kanë qenë aktiv në kërkimin e një pune gjatë katër javëve të fundit. Mënyrat më të përdorura për të gjetur punë kanë qenë: njohjet familjare dhe miqësore (78.9%), lajmërimet e publikuara në mediumet e ndryshme (55.4%), si dhe kontakti i drejtpërdrejtë me punëdhënësin (39.4%). Vetëm 13% e tyre kanë kërkuar për punë nëpërmjet Zyrave të Punës.
- 84.7% e të diplomuarve në kërkim të një pune nuk janë regjistruar në zyrat e punës për të kërkuar punë, pjesa më e madhe për mungesë interesi (47.2%) ose besimi që zyrat e punës mund t'i ndihmojnë (28.8%). Ndërkohë që nga ata të cilët janë regjistruar, vetëm 35% deklarojnë se zyra e punës po i ndihmon në gjetjen e një pune.
- 45% e të papunëve shprehen se nuk kanë qenë aktiv në kërkimin e një pune gjatë katër javëve të fundit. Ata shprehin si arsye kryesore: mungesën e dëshirës për të punuar (24.5%), pritjen për sezonin e përshtatshëm (21.7%), planet për t'u larguar nga vendi (19.6%) dhe mungesën e besimit për gjetjen e një pune (18.2%).
- Rreth 40% e të diplomuarve të papunë në kërkim të një pune pohojnë se kanë qenë të punësuar më parë, ndërkohë që pjesa tjetër nuk ka punuar asnjëherë.
- Rreth 58% e femrave të diplomuara dhe 24.2% e meshkujve kanë zgjedhur të vazhdojnë studimet e mëtejshme. 92% e tyre vazhdojnë studimet universitare dhe vetëm 6.7% e tyre vazhdojnë formim profesional. Pjesa më e madhe (70%) e të diplomuarve që vazhdojnë studimet e mëtejshme zgjedhin institucionet publike dhe vetëm 30% e tyre zgjedhin institucionet private për të vazhduar studimet e mëtejshme. Shumica e të diplomuarve që vazhdojnë studime apo trajnime të mëtejshme, 68% e tyre (deklarojnë se fusha e studimeve të tyre aktuale lidhen me studimet e tyre të mëparshme.
- 83.4% e të diplomuarve do të zgjidhnin sërish të njëjtën shkollë nëse do të kishin mundësi dhe 83% e të diplomuarve do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional.
- Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës vlerësohen se kanë nevojë për shumë përmirësim nga 46.9% e të gjithë të diplomuarve të anketuar, metodat e mësimdhënies 42.7%. 31.7% mendonin që kurrikula kanë nevojë për shumë përmirësim dhe tekstet dhe materialet mësimore në masën 35.4%. 4 në 10 të diplomuar (40.5%) vlerësonin se infrastruktura në shkollë kishte nevojë për shumë përmirësim.
- Praktika në shkollë dhe praktika profesionale në biznes vlerësohet se ka nevojë për shumë përmirësim nga 45.7% dhe 43.3% e të diplomuarve. 44.5% mendojnë se këshillimi i karrierës duhet të përmirësohet në një shkallë të konsiderueshme.
- Të pyetur rreth pritshmërive të tyre për 2 vitet e ardhshme, në 17.9% të rasteve të diplomuarit dëshironin të ishin të punësuar pavarësisht profilit, ndërsa 36.8% të ishin të punësuar në një punë që lidhej me fushën e tyre të studimeve. Në 24.6% të rasteve, ata planifikonin të hapnin një biznes, ndërsa 36.5% të emigronte jashtë vendit.

HYRJE

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit apo të certifikuarit e një institucioni arsimor realizohet nëpërmjet 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' të diplomuarit pasi ata diplomohen/certifikohen. Gjurmimi i të diplomuarve është një praktikë e konsoliduar dhe standarde në sektorin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Evropë. Të dhënat nga studimet gjurmuese përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi relevancën e ofertës për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura (shiko për shembull Schomburg, 2016)¹.

Në Shqipëri, ndryshimet në vitet e fundit në kuadrin rregullator dhe të politikave kanë filluar të zëvendësojnë praktikatat ad hoc të gjurmimit me praktika sistematike dhe standarde – si në nivel kombëtar dhe në nivel institucioni arsimor apo ofruesi. Në nivelin e politikave, në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, ngritja e një sistemi gjurmimi me ndjeshmëri për çështjet gjinore për të diplomuarit nga AFP (nga kualifikimi bazë dhe më tej) u listua si objektiv nën Përparësinë Strategjike D të Fuqizimit të qeverisjes së tregut të punës dhe sistemeve të kualifikimit. Në përputhje me ligjin nr.15/2017 'Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë' është institucionalizuar gjurmimi në nivel kombëtar me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) përgjegjëse për kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së (neni 9/2 i ligjit). Ndërkohë, institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP) janë përgjegjëse nëpërmjet Njësisë së zhvillimit për gjurmimin në nivel ofruesi. (neni 15 i ligjit).

Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të AFP në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve. Ato përfaqësojnë një nga burimet e rëndësishme për vlerësimin dhe mbështetjen në përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së AFP me tregun e punës. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionit nga institucioni arsimor në tregun e

punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve. Të dhënat në këtë fushë kanë qenë relativisht të kufizuara në Shqipëri, por sfidat e rëndësishme për sa i përket garantimit të punësimit të sigurt dhe produktiv si dhe sigurimin e integritetit në tregun e punës të rinjve dhe të grupeve vulnerabël mund të trajtohen në mënyrë të duhur vetëm me bazë evidencën.

Në këtë drejtim, gjurmimi në nivel kombëtar është veçanërisht i rëndësishëm për të informuar ministrinë përgjegjëse dhe entitetet e tjera në nivel qendror mbi treguesit e tregut të punës të të diplomuarve dhe aspekteve të tjera për të ndikuar te monitorimi dhe politikë-bërja me bazë evidencën, ndërkohë gjurmimi në nivel ofruesi është relevant për punën dhe organizimin e ofruesve individualë dhe komplementon gjurmimin në nivel kombëtar. Tabela më poshtë prezanton një krahasim midis gjurmimit në nivel kombëtar dhe gjurmimit në nivel ofruesi:

Gjurmimi në nivel kombëtar

Informon ministrinë përgjegjëse dhe entitetet e tjera në nivel qendror mbi treguesit kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit nga sistemi i AFP-së

Informon për zhvillimin dhe përmirësimin e politikave në nivel qendror

Ndihmon në analizën e mospërputhjeve të aftësive në nivel kombëtar

Gjurmimi në nivel ofruesi

Siguron monitorimin sistematik të treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e institucionit

Ndihmon në menaxhimin e planifikimit dhe monitorimit e ofertës të institucionit

Lehtëson proceset mbështetëse të orientimit dhe këshillimit në karrierë për nxënësit

Ndihmon në marketingun institucional

Është **fleksibël** dhe çdo institucion mund ta përshtatë sipas nevojave të tij

Komplementon gjurmimin në nivel kombëtar

Tabela 1 Gjurmimi kombëtar vs. gjurmimi në nivel ofruesi

Në këtë kuadër, AKPA me mbështetjen e projektit Skills for Jobs (S4J) ndërmori gjurmimin në nivel kombëtar të të diplomuarve të brezit 2019-2020 nga 36 shkollat publike të arsimit profesional në 12 qarqet e Shqipërisë me qëllimin e përgjithshëm të monitorimit të treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit nga sistemi i AP.

Objektivat specifike të gjurmimit në nivel kombëtar mund të përmbledhen si më poshtë:

- Vlerësimi i statusit të përgjithshëm të punësimit të të diplomuarve nga AP;
- Vlerësimi i diferencave në statusin e punësimit sipas gjinisë, rajoneve, apo sektorit të ekonomisë;
- Identifikimi i treguesve specifike rreth integritetit në tregun e punës për të diplomuarit, si koha mesatare në gjetjen e punës së parë, mënyrat e gjetjes së punës së parë, profili i punës etj.
- Analizimi i të diplomuarve të punësuar në lidhje me tipare si relevanca e studimeve me vendin e punës, paga, kushtet e punës etj.
- Analizimi i të diplomuarve që zgjedhin të ndjekin kualifikime të mëtejshme pas diplomimit;
- Vlerësimi i institucioneve ofruese bazuar në perceptimin retrospektiv të të diplomuarve;
- Krijimi i një baze për studimet dhe analizat e mëtejshme gjurmuese në nivel kombëtar për të krijuar një standard në këtë drejtim.

1412 të diplomuar nga 36 shkolla të arsimit profesional iu përgjigjën sondazhit të gjurmimit gjatë periudhës shkurt-prill 2021 ose 8-10 muaj pas diplomimit të tyre. Ky raport përshkruan dhe analizon të dhënat dhe rezultatet e përgjithshme mbi rrugëtimin profesional të të diplomuarve pas mbarimit të studimeve, integrimin e tyre në tregun e punës, si dhe aspekte të tjera që mund të ndihmojnë drejt vlerësimit të orientimit drejt tregut të sistemit të AFP-së në Shqipëri. Rezultatet kryesore janë paraqitur në përputhje me objektivat e studimit të gjurmimit.

Raporti është strukturuar si më poshtë vijon. Seksioni në vijim përshkruan metodologjinë e ndjekur për gjurmimin kombëtar. Me tej analizohen në detaj rezultatet për a) kategorinë e të diplomuarve të punësuar, b) të

diplomuarve që ndjekin kualifikime të mëtejshme, c) të diplomuarve pa punë, si dhe d) perceptimet mbi vlerësimin e institucioneve bazuar në vlerësimin retrospektiv të të diplomuarve.

Për një analizë gjithë-përfshirëse të situatës, informacioni mbi të dhënat e gjurmimit dhe përvojën e të diplomuarve duhet të komplementohet me të dhëna mbi parashikimin e aftësive për kualifikime në treg për të përmirësuar procesin e përputhshmërisë (matching). Kjo është e nevojshme në mjedisin dinamik të tregut të punës, të karakterizuar nga përparimet në teknologji dhe konkurrueshmëri. Evidencat dhe informacioni mbi tregun e punës duhet të përdoret për të rritur relevancën e ofertës mësimore duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Kjo do të mundësojë që në të ardhmen të diplomohen specialistë më të kualifikuar dhe sipas nevojave të kompanive, si dhe të realizohet një tranzicion më i shpejtë i të diplomuarve në tregun e punës dhe të arrihet një produktivitet më i lartë i kompanive shoqëruar me paga më të larta të të diplomuarve nga AFP.

¹ Marrë nga: <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/carrying-out-tracer-studies-guide-anticipating-and-matching>

² Objekti D3.2. Marrë nga: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimi.pdf

³ Raporti i fundit i gjurmimit kombëtar është realizuar për të diplomuarit e 2017-2018.

Qasja metodologjike

Për studimin e gjurmimit kombëtar të të diplomuarve nga shkollat e arsimit profesional u përdor një model hulumtimi tërthorë ku të dhënat u mbledhën nëpërmjet pyetësorëve të standardizuar përgjatë muajit shkurt deri në muajin prill 2021. Popullata e cila u studiua janë të diplomuarit në vitin 2020 nga shkollat publike të arsimit profesional.

Madhësia e popullatës së synuar ishte e vogël në numër – rreth 4101 nxënës të diplomuar nga 36 shkolla në vitin 2020. Për këtë arsye u zgjodh të kryhet një census në mënyrë që të merret një informacion i plotë dhe që çdo i diplomuar të ketë të njëjtën mundësi pjesëmarrjeje në studim.

Ky studim nuk është i pari që kryhet për këtë grup të shënjestruar. Këto studime janë realizuar duke përdorur një kampion në bazë të numrit total të të diplomuarve. Por duke marrë parasysh nevojat për të gjeneruar indikatorë të disagreguar në nivel: rajoni, grupi social, drejtimi mësimor etj. duhej realizuar censusi i popullatës për secilën shkollë në vend të përzgjedhjes së një kampioni nga tërësia e popullatës. Për kontaktin e të diplomuarve u përdor baza e të dhënave të disponueshme e siguruar nga AKPA. Nga një analizë paraprake e të dhënave, rezultoi se informacioni demografik dhe i kontaktit të individëve që do të intervistoheshin ishte në disa raste jo i plotë. Kjo ishte një arsye më shumë pse u zgjodh censusi, si një proces që mundëson mbledhjen e të dhënave për të gjithë popullatën, në mënyrë që të përditësohen edhe të dhënat aktuale demografike/të kontaktit.

Koha kur u intervistuan të diplomuarit ishte përafërsisht 8-10 muaj pas diplomimit të tyre. Kjo periudhë mund të konsiderohet e mjaftueshme që të diplomuarit të jenë integruar në tregun e punës ose të jenë në kërkim aktiv të një pune.

Ne fund të procesit informacioni i mbledhur mbuloi 1412 të diplomuar ose 34% të tyre. Pjesa më e madhe si pasojë e kontakteve të gabuara, ndërsa një pjesë tepër e vogël si pasojë e refuzimit. Megjithatë, 34% është një shkallë e konsiderueshme për të nxjerrë rezultate të sakta (më shumë për këtë në seksionin Përshkrimi i demografisë).

Instrumenti i studimit - pyetësori

Të dhënat për studimin e gjurmimit u bazuan në një pyetësor të standardizuar të organizuar me blloqe kryesore pyetjesh. Pyetësori kaloi në një fazë diskutimi, si në lidhje me përmbajtjen dhe me mënyrën e organizimit.

Duke u nisur nga fakti se qëllimi kryesor i anketimit ishte të studiohej përfshirja e nxënësve të diplomuar në tregun e punës, pyetja më kryesore ishte statusi i tyre në momentin e anketimit.

Grupet në të cilat ndaheshin të anketuarit ishin:

- të punësuar (të punësuar, studentë që punonin dhe studionin në të njëjtën kohë)
- të vetë-punësuar
- të papunë aktivë
- joaktivë (studentë, shtëpiakë, të dekurajuar, PAK)

Secili nga grupet kishte bllokun e pyetjeve korrespondente sipas karakteristikave përkatëse.

Disa nga pyetjet për grupin e parë dhe të dytë (të diplomuarit në marrëdhënie pune) ishin:

- koha e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- mënyra e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- përputhja e drejtimit me vendin e punës
- intervali i pagës
- dobia e njohurive të marra në shkollë në vendin e punës
- siguria dhe kënaqshmëria me vendin e punës

Për grupin e tretë ose të papunët:

- perceptimi mbi statusin
- roli i zyrave të punës për të gjetur punë

Për grupin e fundit ose të diplomuarit ekonomikisht joaktivë rëndësi të veçantë kishin si të dekurajuarit, dhe ata që po ndiqnin kualifikime të mëtejshme. Për të dekurajuarit, qëllimi ishte të merrej informacion pse ata nuk e mendonin veten të aftë për të gjetur një punë, ndërsa për ata që po ndiqnin kualifikime të mëtejshme, lloji i kualifikimit, arsyeja e ndjekjes së studimeve, si dhe lidhja e tyre me drejtimin profesional.

Për të gjithë të anketuarit pavarësisht statusit të punësimit u drejtua një grup i njëjtë pyetjesh mbi:

- nevojën për përmirësime në aspekte të veçanta në shkollë
- perspektivën e tyre për të ardhmen profesionale

Në kontekstin e situatës së shkaktuar nga pandemia e COVID-19-ës u përdorën intervistat telefonike, me anë të një teknike të njohur si CATI (Computer-assisted telephone interviewing) në të cilën intervistuesi telefonon të anketuarin dhe regjistron përgjigjet e tij në një aplikacion kompjuterik, i cili administrohet online nëpërmjet përdorimit të Platformës Kobo Toolbox .

Për kryerjen e pyetësorit për të diplomuarit u angazhuan dy persona të cilët u trajnuan nga eksperti i metodologjisë për mënyrën e duhur të administrimit. Pyetësori zgjaste mesatarisht rreth 6 minuta.

Analizimi i të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave, u realizua pastrimi, tabulimi dhe analizimi i tyre duke përdorur programin statistikor SPSS. Tabulimi dhe analiza përfshijnë:

- përshkrimin deskriptiv të të dhënave nëpërmjet tabelave dhe grafikëve të ndryshëm
- teste të ndryshme joparametrike që përdoren për të studiuar lidhjet midis të dhënave duke qenë se pjesa më e madhe e tyre janë josasiore

Rezultatet janë prezantuar dhe analizuar në raport në agregat dhe sipas parashikimeve të ndarjes rajonale të optimizimit të ofruesve të AFP-së, që i ndajnë ofruesit në 4 rajone siç tregohet më poshtë.




Tabela 2 Parashikimi i optimizimit në 4 rajone sipas shkollave

Kufizimet metodologjike

Bazuar në faktin që anketa duhej të ishte census të dhënat duhet të merreshin për të tërë popullatën, por vetëm 34% e të diplomuarve në vitin 2020 arritën të intervistoheshin. Kjo shkallë më e ulët vjen kryesisht si pasojë e kontakteve të paplota dhe të gabuara në disa raste në databazën e popullatës, si dhe vështirësive të periudhës kur u krye anketa (pandemia e Covid-19-ës). Megjithatë, 34% e të diplomuarve ose 1412 është një numër me të cilin mund të kryen analiza të sakta dhe mund të nxirren përfundime pasi të dhënat janë përfaqësuese.

Bazuar në këtë analiza, studimet e gjurmimit në vijim mund të kryen me kampionim.

/ PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË

Bazuar në të dhënat e mbledhura, më poshtë është analiza demografike rreth shpërndarjes së të intervistuarve.

Në tabelën 3 jepet shpërndarja e të diplomuarve dhe të anketuarve sipas gjinisë.

Gjinia	Të çertifikuar	%	Të anketuar	%
Femra	800	19.5	193	13.7
Meshkuj	3301	80.5	1241	86.3
Totali	4101	100	1407	100

Shënim: Për 5 të anketuar mungojnë të dhënat mbi gjininë.

Tabela 3 Shpërndarja sipas gjinisë

Nga të dhënat e tabelës, 80.5% e të diplomuarve nga shkollat e arsimit profesional në 2020 ishin meshkuj, ndërsa vetëm 19.5% ose 2 në 10 të diplomuar ishin femra. Afërsisht kjo lloj përqindjeje është ruajtur dhe te të diplomuarit që i janë përgjigjur pyetësorit – ku 13.7% ishin femra ndërsa 86.3% meshkuj. Kjo i bën të dhënat e mbledhura përfaqësuese në nivel gjinie.

Ndërkohë, 25 nga 1412 të diplomuarit e anketuar ose 1.8% i përkisnin një pakice kombëtare krahasuar me 76 nga 4101 ose 1.8% e popullatës, pra e njëjta përqindjeje. 4 të anketuar ishin përfutës të pagesës për aftësinë e kufizuar (PAK) krahasuar me 22 në popullatë.

69.2% e të anketuarve kanë ndjekur 5 nga 20 drejtimet mësimore duke reflektuar kështu edhe përqindjet në popullatë. Drejtimi më i përfaqësuar është Shërbime Mjetesh Transporti me 20.3%, ndjekur nga Hoteleri-Turizëm me 14.7%, Elektroteknika me 13.1%, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK) me 9.2% dhe Ekonomi-Biznes me 7.8%.



Drejtimi	Të anketuarit	% të anketuarit
Shërbime Mjetesh Transporti	282	20.3
Hoteleri-Turizëm	204	14.7
Elektroteknikë	182	13.1
TIK	165	11.9
Ekonomi-Biznes	128	9.2
Mekanikë	108	7.8
Termohidraulikë	71	5.1
Bujqësi	50	3.6
Teknologji Ushqimore	47	3.4
Shërbime sociale dhe shëndetësore	37	2.7
Veterinari	27	1.9
Inxhinieri informatike software	25	1.8
Tekstil-konfeksione	19	1.4
Ndërtim	10	0.7
Përpunim druri	9	0.6
Gjeodezi	8	0.6
Detari	6	0.4
Gjeologji-miniera	6	0.4
Kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë, gaz dhe uj	5	0.4
Pyje	3	0.2
Total	1392	100

Tabela 4 Shpërndarja sipas drejtimeve mësimore

Për të studiuar nivelin e performancës sipas rajoneve analiza e bërë duhet të kryhet dhe në ato nivele, por që kjo analizë të jetë përfaqësuese duhet që përqindja e të anketuarve të jetë e përafërt me shpërndarjen e popullatës sipas rajoneve. Tabela 5 paraqet këtë shpërndarje të të diplomuarve dhe të anketuarve sipas rajoneve. Të dhënat e mbledhura janë përfaqësuese për çdo rajon.

Rajonet	Të diplomuarit		Të anketuarit	
	#	%	#	%
Rajoni Verior	537	13.1	207	14.7
Rajoni Qendror	2100	51.2	619	43.8
Rajoni Juglindor	912	22.2	336	23.8
Rajoni Jugperëndimor	552	13.5	250	17.7
Total	4101	100%	1412	100%

Tabela 5 Shpërndarja sipas rajoneve

/ REZULTATET

Situata e punësimit e të diplomuarve

Ky seksion paraqet rezultatet e përgjithshme mbi statusin e punësimit dhe indikatorët e tjerë të tregut të punës për të diplomuarit e brezit 2019-2020 nga shkollat publike të arsimit profesional në Shqipëri. Seksioni analizon rezultatet e brezit në tregun e punës rreth 8-10 muaj pas diplomimit.

Kjo anketë përdor numrin e përgjithshëm të të diplomuarve që i janë përgjigjur pyetësorit (të diplomuarit e anketuar) si popullsia. Në përputhje me përkufizimet ndërkombëtare, indikatorët llogariten si më poshtë:



Forca e punës ose të diplomuarit ekonomiksht aktivë në tregun e punës është llogaritur si shuma e të diplomuarve të deklaruar të punësuar dhe të papunë që po kërkonin për punë në momentin e anketimit. Studentët përfshihen në kategorinë ekonomiksht joaktive.



Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë (popullsia në këtë rast të diplomuarit e anketuar).



Shkalla e punësimit është llogaritur si raporti i atyre që janë deklaruar të punësuar, të vetë-punësuar ose që dhe punojnë dhe studiojnë kundrejt popullsisë në moshë pune (popullsia në këtë rast të diplomuarit e anketuar)



Shkalla e papunësisë është llogaritur si raporti i të papunëve që po kërkonin për punë në momentin e anketimit kundrejt forcës së punës.




Shpërndarja sipas statusit të punësimit/të diplomuarit e punësuar përfshin të anketuarit të deklaruar të punësuar, të vetë-punësuar ose të punësuar me kohë të pjesshme në momentin e intervistimit kundrejt të gjithë të diplomuarve të anketuar.



Shpërndarja sipas statusit të punësimit/të diplomuarit e papunë përfshin të anketuarit të deklaruar të papunë që po kërkonin për punë në momentin e intervistimit kundrejt të gjithë të diplomuarve të anketuar.

Situata aktuale e punësimit

Shpërndarja sipas statusit të punësimit tregon se, në total, 4 në 10 të diplomuar nga arsimi profesional në 2020 ose 40.2% e të diplomuarve ishin në marrëdhënie pune 8-10 muaj pas diplomimit, nga të cilët 30.9% ishin të punësuar me pagë, 4.4% ishin të vetë-punësuar, ndërsa 4.9% punonin dhe studionin në të njëjtën kohë. 28.8% e të diplomuarve ndiqnin kualifikime të mëtejshme si studentë apo kursantë. Ndërkohë, afërsisht 30% ishin të papunë në momentin e anketës, por vetëm 22.9% ishin të papunë që po kërkonin aktivisht për punë.



Të dhënat tregojnë dallime në shpërndarjen e statusit të punësimit sipas gjinisë. Të diplomuarit meshkuj ishin më të prirur se të diplomuarat femra për të qenë të punësuar me 43.7% e meshkujve të punësuar përkundrejt vetëm 18.1% të femrave. Ndërkohë, femrat ishin më të prirura për të qenë ekonomikisht joaktive (67.9% e femrave krahasuar me 37% e meshkujve). Arsyeja kryesore e të qenit joaktivë për të dyja gjinitë lidhet me përfshirjen në arsim dhe trajnim të mëtejshëm, por për popullsinë e femrave kjo paraqitet më e theksuar, ku 58% ishin studente apo kursante krahasuar me 28.9% të meshkujve. Gjithashtu, femrat ishin më të prirura për t'u angazhuar më përbushjen e detyrave shtëpiake (6.2% krahasuar me 0.2%).

	Total		Mashkull		Femër	
	N	%	N	%	N	%
Të punësuar	565	40.2%	530	43.7%	35	18.1%
I/E punësiar	434	30.8%	409	33.7%	25	13%
I/E vetë-punësuar	62	4.4%	61	5%	1	0.5%
Punë dhe studioj në të njëjtën	69	4.9%	60	4.9%	9	4.7%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	321	22.8%	294	24.2%	27	14%
Joaktive	521	37%	390	32.1%	131	67.9%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	100	7.1%	93	7.7%	7	3.6%
Student/Kursant	406	28.9%	294	24.2%	112	58%
Duke përbushur detyrat shtëpiake	14	1%	2	0.2%	12	6.2%
Tjetër	1	0.1%	1	0.1%	0	0%
TOTAL	1407	100%	1214	100%	193	100%

Tabela 6 Statusi i punësimit sipas gjinisë


Edhe ndarja sipas rajoneve shpërfaq ndryshime në statusin e punësimit të të diplomuarve pas mbarimit të arsimit profesional. Të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor ishin më të prirur për të qenë të punësuar pas diplomimit krahasuar me rajonet e tjera, nga ku 46.8% e të diplomuarve ishin të punësuar në krahasim me vetëm një të tretën ose 33.3% në Rajonin Verior. Ndërkohë, të diplomuarit në Rajonin Qendror ishin më të prirur për të ndjekur kualifikime të mëtejshme – rreth 37.5% e tyre krahasuar me 18.5% e Rajonit Juglindor.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor
Të punësuar	33.3%	41.9%	36.4%	46.8%
I/E punësiar	26.1%	30.5%	27.4%	40.8%
I/E vetë-punësuar	5.8%	4.5%	4.2%	3.2%
Punoj dhe studioj në të njëjtën	1.4%	6.9%	4.8%	2.8%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	27.5%	14.9%	36.9%	20%
Joaktivë	39.1%	43.1%	26.8%	33.2%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	12.6%	4.7%	7.1%	8.4%
Student/Kursant	24.2%	37.5%	18.5%	24.8%
Duke përmbushur detyrat shtëpiake	2.4%	0.8%	1.2%	0%
Tjetër	0%	0.2%	0%	0%

Baza e përgjigjeve: N1=207, N2=617, N3=336, N4=250

Tabela 7 Cila është situata jote aktuale e punësimit (sipas rajoneve)?

Ndarja sipas sektorëve tregon dallime në statusin e punësimit dhe përfshirjen në tregun e punës në varësi të drejtimit profesional që kanë ndjekur të diplomuarit. Të diplomuarit nga drejtimet me karakter industrial ishin më të prirur për t'u punësuar në krahasim me drejtimet e tjera. Kështu, më shumë se gjysma e të diplomuarve të Elektroteknikës (53.3%) dhe SHMT (Shërbime mjetesh transporti) (52.8%) ishin tashmë të punësuar pas mbarimit të arsimit profesional. Në sektorin e Hoteleri-Turizmit, 43.6% e të diplomuarve ishin të punësuar, ndërsa 26.5% ishin studentë ose kursantë duke u kualifikuar më tej. Nga ana tjetër, të diplomuarit e Ekonomi-Biznes ishin më të prirur për të qenë ekonomikisht joaktivë dhe të ndiqnin studime apo trajnime të mëtejshme pas diplomimit krahasuar me drejtimet e tjera. Më pak se 6 në 10 të diplomuar ose 57.8% ishin studentë, ndjekur nga të diplomuarit e TIK ku 46.7% ishin studentë. Ndërkohë, të diplomuarit e Mekanikës kishin më shumë probleme për t'u integruar në tregun e punës dhe një papunësi më të lartë. 43.5% e të diplomuarve ishin pa punë dhe duke kërkuar aktivisht për punë në momentin e anketimit. Grafiku në vijim paraqet statusin e punësimit të të diplomuarve sipas drejtimeve, për drejtimet profesionale me më shumë se 100 të diplomuar të anketuar.



Në lidhje me punësimin e të diplomuarve që i përkasin kategorisë PAK (4 në total), 1 ishte i punësuar, 1 pa punë dhe po kërkonte për punë, ndërsa 2 po ndiqnin kualifikime të mëtejshme. Në lidhje me punësimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian (23 në total), rezultojnë 8 të punësuar dhe 8 pa punë.

Në seksionet në vijim analizohen në detaj gjetjet kryesore të gjurmimit për çdo kategori punësimi.

Të diplomuarit e punësuar

Ky seksion prezanton rezultatet e gjurmimit për kategorinë e të diplomuarve të punësuar duke përshkruar përvojën e tyre gjatë tranzicionit dhe integritimit në tregun e punës. Të dhënat paraqiten në total dhe të ndara sipas rajoneve.


Tranzicioni drejt tregut të punës – koha e gjetjes së punës së parë

Të dhënat e gjurmimit tregojnë se të diplomuarit nga arsimi profesional integrohen relativisht lehtë në tregun e punës. 60.5% e të diplomuarve të punësuar kishin gjetur punën e tyre të parë që para mbarimit të shkollës. Ndërkohë, ndarja sipas rajoneve tregon që tranzicioni është më i ngadaltë për të diplomuarit e Rajonit Qendror. Vetëm gjysma e të diplomuarve ose 50.7% e kishin gjetur punën e tyre të parë para diplomimit, krahasuar me mbi 68% të të diplomuarve nga rajonet e tjera.

Kur e ke filluar punën tënde të parë?	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Që para diplomimit/mbarimit të shkollës	68.4%	50.7%	69.2%	69.9%	60.5%
1 muaj pas diplomimit	12.3%	13.5%	5.6%	6.5%	10.3%
1 - 3 muaj pas diplomimit	15.8%	23.1%	16.8%	12.9%	18.9%
3 - 6 muaj pas diplomimit	1.8%	11.8%	4.7%	6.5%	8.0%
6 - 9 muaj pas diplomimit	1.8%	.4%	2.8%	3.2%	1.6%
9 - 12 muaj pas diplomimit	0.0%	.4%	.9%	1.1%	.6%

Baza e përgjigjeve: N1=57, N2=229, N3=107, N4=93, N=486
Tabela 8 Kur e ke filluar punën tënde të parë pas mbarimit të shkollës? (si % e të diplomuarve që janë të punësuar)

Në total, rreth 9 në 10 të diplomuar të punësuar (89.7%) e kishin gjetur punën e tyre të parë brenda 3 muajve pas mbarimit të shkollës. Të diplomuarit meshkuj ishin më të prirur se të diplomuarat femra për t'u integruar më shpejt në tregun e punë. 90.6% e meshkujve e kishin gjetur punën brenda 3 muajve krahasuar me 76.5% të femrave.



Nëse fokusohemi te kategoria e të vetë-punësuarve, 55.9% e të diplomuarve punonin në biznesin e familjes dhe kjo përqindje ishte më e lartë për Rajonin Jugperëndimor (71.4%) dhe Rajonin Verior (66.7%). 23.7% e kishin hapur biznesin e tyre para mbarimit të shkollës. Të diplomuarit e Rajonit Juglindor ishin të prirur të merrnin më shumë kohë për hapjen e biznesit në krahasim me rajonet e tjera.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Është biznesi i familjes	66.7%	50.0%	50.0%	71.4%	55.9%
E kam hapur para diplomimit	25.0%	26.9%	14.3%	28.6%	23.7%
1 muaj pas kursit	8.3%	3.8%	14.3%	0.0%	6.8%
1 -3 muaj pas kursit	0.0%	11.5%	21.4%	0.0%	10.2%
3 - 6 muaj pas kursit	0.0%	7.7%	0.0%	0.0%	3.4%

Baza e përgjigjeve: N1=12, N2=26, N3=14, N4=7, N=59
Tabela 9 Sa kohë pas diplomimit t'u desh që të hapje biznesin tënd?

Tranzicioni drejt tregut të punës – mënyra e gjetjes së punës së parë

Njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë përfaqësojnë mënyrën më të shpeshtë sesi të diplomuarit e punësuar kishin gjetur punën e tyre të parë. 58.2% e të diplomuarve kishin gjetur punë nëpërmjet njohjeve dhe lidhjeve familjare. Përdorimi i këtyre kanaleve joformale ishte më i theksuar për të diplomuarit e Rajonit Qendror (65.4%) dhe më pak i përdorur nga të diplomuarit e Rajonit Juglindor (47.3%). Mënyra e dytë më e përdorur ishte duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin, e përdorur nga 24.7% e të diplomuarve. Kjo mënyrë ishte më e përdorur në Rajonin Jugperëndimor (34.1%) dhe më pak e përdorur në Rajonin Qendror (16.2%). 9.6% e të diplomuarve të punësuar kishin gjetur punën e tyre të parë nëpërmjet praktikës profesionale në biznes. Kanalet e tjera si zyra e punës, lajmërimet e publikuara në media apo agjencitë private të punësimit përfaqësonin më pak se 4%. Nuk ka ndryshime në mënyrën e gjetjes së punës së parë sipas drejtimeve profesionale që kanë mbaruar të diplomuarit.




	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nëpërmjet Zyrës së Punës	0.0%	.9%	1.0%	1.1%	.8%
Nëpërmjet përgjigjes së lajmërimeve të publikuara	1.8%	47.3% 4.4%	2.9%	2.2%	3.3%
Nga praktika profesionale në biznes	8.8%	10.1%	5.7%	13.2%	9.6%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	52.6%	65.4%	55.2%	47.3%	58.2%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	31.6%	16.2%	31.4%	34.1%	24.7%
Nga mësuesit/instruktorët në shkollë	3.5%	1.8%	1.9%	1.1%	1.9%
Nëpërmjet një agjencie private të punësimit	0.0%	.4%	0.0%	0.0%	.2%
Tjetër	1.8%	.9%	1.9%	1.1%	1.2%

Baza e përgjigjeve: N1=57, N2=228, N3=105, N4=91, N=481
Tabela 10 Si e gjete punën tënde të parë?

Integrimi në tregun e punës – karakteristikat kryesore në punë aktuale

Ky seksion analizon karakteristikat e vendit të punës për të diplomuarit në marrëdhënie pune gjatë momentit të anketimit. Pak më shumë se një e treta e të diplomuarve (31.5%) kishin 6-9 muaj në punën e tyre aktuale, ndërsa 23.5% rreth 3-6 muaj. Kjo korrespondon me të dhënat e mëparshme që tregonin se të diplomuarit arrinin të integroheshin relativisht lehtë në tregun e punës pas mbarimit të shkollës. 19.1% e të diplomuarve kishin më pak se 3 muaj në punën e tyre aktuale dhe vetëm 8% më pak se 1 muaj. Ndërkohë, krahasimi i rajoneve tregon që të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor kishin më shumë kohë në punën e tyre aktuale krahasuar me rajonet e tjera (rreth 41.2%).



	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Më pak se 1 muaj	4.5%	8.1%	9.4%	8.8%	8.0%
1 - 3 muaj	9.1%	27.0%	21.9%	5.9%	19.1%
3 - 6 muaj	36.4%	23.0%	21.9%	17.6%	23.5%
6 - 9 muaj	27.3%	31.1%	25.0%	41.2%	31.5%
Tjetër	22.7%	10.8%	21.9%	26.5%	17.9%

Baza e përgjigjeve: N1=22, N2=74, N3=32, N4=34, N=162
Tabela 11 Sa kohë ke që punon te puna aktuale?

Në total 66.3% e të diplomuarve gjendeshin në punën e tyre të parë pas diplomimit dhe kjo përqindje ishte më e madhe për të diplomuarit e Rajonit Juglindor (70.1%). Ndërkohë rreth një e treta e të diplomuarve kishin ndërruar 1-2 punë pas përfundimit të shkollës.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Asnjë	61.4%	66.5%	70.1%	64.5%	66.3%
1	14.0%	4.5%	1.9%	4.3%	5.0%
2	15.8%	19.2%	15.9%	17.2%	17.7%
Tjetër	8.8%	9.8%	12.1%	14.0%	11.0%


Baza e përgjigjeve: N1=57, N2=224, N3=107, N4=90, N=481
Tabela 12 Sa punë ke ndërruar që nga diplomimi/puna jote e parë?

Ata që kishin ndërruar punë kryesisht ishin larguar për arsye personale ose për një pagë më të mirë te puna e re ku kishin lëvizur. Rreth 34.4% e të diplomuarve ishin larguar nga puna e tyre e fundit pasi u ishte ofruar një pagë më e mirë te puna e re. Kjo arsye ishte më e theksuar te të diplomuarit e punësuar të Rajonit Verior (40.9%) dhe Rajonit Qendror (39.2%). Vetëm 17.5% e të diplomuarve kishin ndërruar punë pasi kishte shkurtime në vendin e punës.


	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Më mbaroi kontrata e punës	9.1%	2.7%	3.1%	3.1%	3.8%
Vendi i punës nuk përputhej me arsimimin tim	9.1%	4.1%	0.0%	3.1%	3.8%
M'u ofrua një pagë më e mirë te puna e re	40.9%	39.2%	21.9%	31.3%	34.4%
Kishte shkurtime në vendin e punës	18.2%	13.5%	18.8%	25.0%	17.5%
Për arsye personale	22.7%	35.1%	56.3%	37.5%	38.1%
Tjetër	0.0%	5.4%	0.0%	0.0%	2.5%

Baza e përgjigjeve: N1=22, N2=74, N3=32, N4=32, N=160
Tabela 13 Cila ishte arsyeja kryesore që u largove nga puna jote e fundit?

Përgjithësisht të diplomuarit nga arsimi profesional angazhohen me kohë të plotë në punët e tyre aktuale. 93% e të diplomuarve punonin më kohë të plotë dhe nuk kishte dallime të theksuar ndërmjet rajoneve.



Rreth 7 në 10 të diplomuar nga arsimi profesional ose 69.9% ishin të punësuar në firma apo biznese që kryenin 3 aktivitete kryesore ekonomike (sipas Klasifikimit NACE Rev.2). 28.2% ishin biznese që kryenin tregti me shumicë dhe pakicë, 22.3% aktivitete të tjera shërbimi, ndërsa 19.4% ishin biznese në sektorin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor.



Pjesa dërmuese e atyre që ishin në marrëdhënie punë punonin në kompani të vogla duke reflektuar kështu edhe realitetin e bizneseve në Shqipëri. 72.8% punonin në kompani me më pak se 10 punonjës. 19.7% punonin në kompani me 10-49 punonjës dhe vetëm 7.5% punonin në kompani të mëdha me mbi 50 punonjës

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
1-4 punonjës	49.1%	41.9%	56.7%	47.9%	47.1%
5-9 punonjës	26.3%	27.8%	21.2%	25.5%	25.7%
10-49 punonjës	19.3%	26.4%	11.5%	12.8%	19.7%
>50 punonjës	5.3%	4.0%	10.6%	13.8%	7.5%

Baza e përgjigjeve: N1=57, N2=227, N3=104, N4=94, N=482

Tabela 14 Sa është numri i punonjësve në kompaninë ku punon?

Kur u pyetën për llojin e kontratës së punës që kishin më punëdhënësin, 74.5% e të diplomuarve deklaroron se nuk kishin kontratë me punëdhënësin. Të diplomuarit e Rajonit Juglindor ishin më të prirur të deklaroron se nuk kishin kontratë (86.3%) përkundrejt të diplomuarve në rajonet e tjera. Ndërkohë, 11.5% e të diplomuarve deklaroron se kishin kontratë me afat të caktuar, ndërsa 13.8% kontratë pa afat.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Kontratë me afat të caktuar	12.3%	14.1%	3.9%	12.9%	11.5%
Kontratë pa afat	10.5%	14.5%	8.8%	19.4%	13.8%
Po bëj praktikë	0.0%	0.0%	1.0%	0.0%	.2%
Jam pa kontratë	77.2%	71.4%	86.3%	67.7%	74.5%

Baza e përgjigjeve: N1=57, N2=227, N3=102, N4=93, N=479

Tabela 15 Çfarë lloj kontrate pune ke me punëdhënësin?



Për të verifikuar vërtetësinë e informacionit në lidhje me llojin e kontratës dhe si tregues i përafërt për informalitetin, të diplomuarit u pyetën në lidhje me pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësit e tyre. Në këtë rast, 74.9% e të punësuarve të diplomuar përgjigjen që u paguheshin kontributet dhe vetëm 3.8% nuk ishin në dijeni të këtij fakti. 21.3% deklaroin se nuk u paguheshin kontributet ose 53 pikë përqindje më pak nga ata që deklaroin se nuk kishin kontratë me punëdhënësin. Të diplomuarit e Rajonit Verior (24.6%) dhe Rajonit Qendror (23.8%) ishin më të prirur për të deklaruar se nuk u paguheshin sigurimet përkundrejt rajoneve të tjera.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Po	73.7%	71.4%	77.2%	81.9%	74.9%
Jo	24.6%	23.8%	17.8%	17.0%	21.3%
Nuk e di	1.8%	4.8%	5.0%	1.1%	3.8%

Baza e përgjigjeve: N1=57, N2=227, N3=101, N4=94, N=479
Tabela 16 A të paguhen sigurimet?

Ndarja sipas drejtimeve profesionale tregon që të diplomuarit në drejtimin Ekonomi-Biznes ishin më të predispozuar për të deklaruar që nuk u paguheshin sigurimet (28%) krahasuar me drejtimit e tjera. Ndërkohë, vetëm më pak se 1 në 10 ose 9.8% e të diplomuarve në Mekanikë deklaroin se nuk u paguheshin sigurimet.




Figura 6 A të paguhen sigurimet (sipas drejtimeve) - % që deklarojnë Jo?

Të pyetur sa të sigurt apo stabilizuar ndihen në punën e tyre aktuale, pjesa më e madhe e të diplomuarve në marrëdhënie pune ndiheshin të sigurt ose shumë të sigurt (67.7%), ndërsa 24.6% kishin një perceptim neutral, pra as të sigurt as të pasigurt. Të diplomuarit e Rajonit Qendror ishin më të prirur të kishin një perceptim neutral të situatës të tyre aktuale krahasuar me rajonet e tjera. Rreth një e treta (32.6%) ishin as të sigurt dhe as të pasigurt në punën e tyre aktuale dhe 58.1% ndjeheshin të sigurt ose shume të sigurt.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
I/E pasigurt	10.5%	9.3%	3.9%	6.4%	7.7%
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	12.3%	32.6%	18.6%	19.1%	24.6%
I/E sigurt	77.2%	58.1%	77.5%	74.5%	67.7%

Baza e përgjigjeve: N1=57, N2=227, N3=102, N4=94, N=480
Tabela 17 Sa i/e sigurt (stabilizuar) ndihesh në punën tënde aktuale?

Ndarja sipas drejtimeve profesionale tregon që të diplomuarit e punësuar që kishin mbaruar drejtime teknike industriale ishin më të prirur për të perceptuar siguri dhe stabilitet në vendin e tyre të punës përkundrejt drejtimeve të tjera. Kështu 85% e të diplomuarve në Mekanikë, 75.7% në Elektroteknikë, 74.2% në SHMT ishin shumë të sigurt ose të sigurt në vendin e tyre të punës, përkundrejt 53.8% në Ekonomi-Biznes dhe 49.4% në Hoteleri-Turizëm.




Figura 7 Sa i/e sigurt (stabilizuar) ndihesh në punën tënde aktuale (sipas drejtimit)


Integrimi në tregun e punës – të ardhurat

Tabela e mëposhtme paraqet nivelin e pagave të të diplomuarve të punësuar në të gjitha grupet e analizuara. Raportimi në lidhje me pagat e të diplomuarve përfshin si të diplomuarit e punësuar ashtu edhe ata të vetëpunësuar. 30.3% e të diplomuarve të punësuar kishin të ardhura nga puna deri në 30,000 lekë. Të diplomuarit nga Rajoni Juglindor ishin më të prirur për të pasur të ardhura nën pagën minimale (rreth 44.4%) përkundrejt të diplomuarve nga Rajoni Qendror (24.2%). 34.8% e të diplomuarve kishin të ardhura në intervalin 30.001-40.000 lekë, ndjekur nga 20.1% në intervalin 40.001-50.000 lekë. 85.2% e të diplomuarve në marrëdhënie pune kishin të ardhura deri në 50,000 lekë. 8.7% e të diplomuarve deklaroin të ardhura nga 50.001-60.000 lekë.


	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Deri në 30.000 lekë	27.5%	24.2%	44.4%	31.0%	30.3%
30.001-40.000 lekë	33.3%	36.5%	30.8%	36.0%	34.8%
40.001-50.000 lekë	11.6%	24.6%	18.8%	16.0%	20.1%
50.001-60.000 lekë	14.5%	10.7%	1.7%	8.0%	8.7%
60.000-95.000 lekë	8.7%	2.8%	3.4%	3.0%	3.7%
95.001-120.000 lekë	2.9%	0.4%	0.0%	2.0%	0.9%
Mbi 120.000 lekë	1.4%	0.8%	0.9%	4.0%	1.5%

Baza e përgjigjeve: N1=69, N2=252, N3=117, N4=100, N=583
Tabela 18 Niveli i pagave (net)

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e pagave sipas gjinisë dhe tregon dallim në paga bazuar te gjinia, me të punësuarat femra që fitojnë më pak se të punësuarit meshkuj. 45.7% e femrave rezultojnë me një pagë nën 30.000 lekë në krahasim me 29.2% e meshkujve. Edhe në kategoritë e tjera të pagave meshkujt zënë pjesën më të madhe, përveç intervalit 50.001-60.000 lekë.



Ndarja e nivelit të pagave sipas drejtimit profesional të të diplomuarve shpërfaq dallime në shpërndarje. Të diplomuarit në drejtimet Mekanikë dhe TIK ishin më të prirur për të pasur të ardhura në intervalet me paga më të larta. Kështu, 23.8% e të diplomuarve në Mekanikë dhe 22.1% e të diplomuarve në TIK siguronin të ardhura më shumë se 50.001 lekë. Të diplomuarit në Ekonomi-Biznes ishin më të prirur për të siguruar të ardhura nën 30.000 lekë përkundrejt drejtimeve të tjera.



Integrimi në tregun e punës – relevanca e arsimit

Përqindja e të diplomuarve të punësuar që nuk janë të angazhuar në një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit shërben si tregues i mospërputhjes midis kërkesës dhe ofertës së tregut të punës. Në total, vetëm pak më shumë se gjysma e të diplomuarve të punësuar ose 52.7% e të diplomuarve, punonin në një punë që lidhej me atë që kishin studiuar. Ndarja sipas rajoneve tregon që të diplomuarit e Rajonit Verior ishin më të prirur për të mos punuar në një vend pune që lidhej me studimet e tyre përkundrejt të gjithë rajoneve të tjera.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Po	73.7%	54.8%	54.2%	55.0%	52.7%
Jo	24.6%	45.2%	45.8%	45.0%	47.3%

Baza e përgjigjeve: N1=67, N2=250, N3=118, N4=100, N=535
Tabela 19 A lidhet puna që bën me atë që ke studiuar?



Kur pyeten pse nuk punonin në një punë që lidhej më atë që kishin studiuar, arsyeja kryesore e deklaruar ishte se nuk kishin gjetur një vend pune që lidhej me studimet e tyre (47.2% e tyre). Kjo arsye ishte më e theksuar për të diplomuarit e Rajonit Juglindor (62.6%). Ndërkohë, arsyeja e dytë ishte që puna e tyre aktuale ofronte pagë dhe kushte më të mira pune (27.8%). Kjo ishte arsyeja kryesore për 39.4% e të diplomuarve të Rajonit Verior. Në total, 13.4% e të diplomuarve në punë nuk dëshironin të punonin në një punë që lidhej me studimet e tyre.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	36.4%	43.3%	1.0%	48.8%	47.2%
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	9.1%	15.5%	13.3%	12.2%	13.4%
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajonin ku punoj	12.1%	11.3%	4.4%	12.2%	10.2%
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	39.4%	28.9%	17.8%	26.8%	27.8%
Tjetër	3.0%	1.0%	2.2%	0.0%	1.4%

Baza e përgjigjeve: N1=33, N2=97, N3=45, N4=41, N=216

Tabela 20 Nëse jo, pse?

Relevanca e punës me studimet shpërfaq dallime gjinore. Të diplomuarit meshkuj ishin më të prirur për të punuar në një vend pune që lidhej me studimet e tyre në krahasim me të diplomuarat femra. 54.2% e meshkujve punonin në një punë relevante në krahasim me vetëm 35.3% e femrave.




Figura 10 Lidhja e punës me studimet sipas gjinisë

Ndarja e të dhënave sipas drejtimeve profesionale tregon që të diplomuarit e drejtimeve të caktuara janë më të prirur për të punuar në një punë që lidhej me studimet e tyre pas mbarimit të shkollës. 68.2% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 67.2% e të diplomuarve në SHMT punonin në një fushë relevante me studimet e tyre, përkundërt vetëm 23.1% të të diplomuarve në TIK dhe 5.9% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes.




Figura 11 Lidhja e punës me studimet sipas drejtimt (% Po)

Përqindja e të diplomuarve që raportojnë se nuk janë duke i shfrytëzuar aftësitë ose arsimimin e tyre në punën aktuale është një tregues i nën-shfrytëzimit të aftësive. Të dhënat e mësipërme rreth mungesës së relevancës së studimeve në vendin e punës, konfirmohen dhe në përdorimin e njohurive të fituara gjatë studimeve në vendin e punës. Kështu, vetëm 46.2% e diplomuarve të punësuar i përdorin njohuritë e fituara gjatë studimeve në një shkallë 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë', ndërsa 47.3% 'aspak' ose 'pak'. Të diplomuarit e Rajonit Verior ishin më të prirur për të mos-shfrytëzuar njohuritë e shkollës (60.9%) krahasuar me rajonet e tjera.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Aspak ose pak	60.9%	46.0%	44.5%	44.6%	47.3%
Disi	4.3%	4.4%	8.4%	10.9%	6.5%
Shumë ose jashtëzakonisht shumë	34.8%	49.6%	47.1%	44.6%	46.2%

Baza e përgjigjeve: N1=69, N2=250, N3=119, N4=101, N=539

Tabela 21 Në ç'skallë i përdor njohuritë që ke fituar gjatë studimeve të tua në punën tënde aktuale?

Në të njëjtën linjë, 45.4% e të diplomuarve deklarorin se pozicioni i tyre aktual lidhej me studimet e tyre në një shkallë 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë' në krahasim me 48.3% e të diplomuarve që deklarorin se lidhej 'aspak' ose 'pak'. Përsëri, të diplomuarit e Rajonit Verior ishin më të prirur për të deklaruar se pozicioni i tyre nuk lidhej me studimet përkundërt të diplomuarve të rajoneve të tjera.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Aspak ose pak	62.3%	47.6%	44.9%	44.6%	48.3%
Disi	4.3%	4.8%	7.6%	9.9%	6.3%
Shumë ose jashtëzakonisht shumë	33.3%	47.6%	47.5%	45.5%	45.4%

Baza e përgjigjeve: N1=69, N2=250, N3=118, N4=101, N=538


Tabela 22 Në ç'skallë është pozicioni yt aktual i lidhur me studimet e tua?

Të diplomuarit që po vazhdojnë kualifikime të mëtejshme

3 nga 10 të diplomuar (ose 28.8 % e të diplomuarve) (N=406) zgjedhin të vazhdojnë studimet apo trajnime të mëtejshme profesionale. Pjesa dërrmuese e tyre 95 % (N = 384) studiojnë me kohë të plotë dhe vetëm 5% (N=19) studiojnë me kohë të pjesshme. Rajoni me përqindjen më të lartë të të diplomuarve që vazhdojnë studimet e mëtejshme është Rajoni Qendror me 57% (N=231), ndërsa rajoni me përqindjen më të ulët të të diplomuarve që vazhdojnë studime të mëtejshme është Rajoni Verior me 12% (N=52). Rreth 58% e femrave (N= 112) të diplomuara dhe 24.2% (294) e meshkujve kanë zgjedhur të vazhdojnë studimet e mëtejshme.

Institucioni Arsimor në të cilin vazhdojnë studimet të diplomuarit

Nga të diplomuarit e vitit 2020 të cilët vazhdojnë studimet e mëtejshme (N= 403), 92% e tyre (N=371) vazhdojnë studimet universitare dhe vetëm 6.7% e tyre (N=27) vazhdojnë formim profesional. Raportin më të lartë të të diplomuarve që vazhdojnë universitetin e ka rajoni Verior dhe ai Qendror me 94% respektivisht. Raportin më të lartë, mes rajoneve, të të diplomuarve që vazhdojnë formim profesional e ka Rajoni Juglindor me 15% të të diplomuarve dhe më të ulët in e ka rajoni Verior me vetëm 2% të të diplomuarve.




Duket se meshkujt kanë një tendencë relativisht më të lartë për të vazhduar studimet e mëtejshme universitare ndërsa femrat zhvillim të vazhduar profesional. Përfshirë bën Rajoni Juglindor ku raportin më të lartë të të diplomuarve që vazhdojnë studimet universitare e zënë femrat me 92% krahasuar me 81% meshkuj të cilët në % më të lartë zgjedhin të vazhdojnë formim profesional (17% respektivisht me 8% femra)

		Universitet	Qendër e Formimit Profesional	Tjetër
Rajoni Verior	Femër	92%	8%	0%
	Mashkull	95%	0%	5%
Rajoni Qendror	Femër	92%	8%	0%
	Mashkull	96%	4%	0%
Rajoni Juglindor	Femër	92%	8%	0%
	Mashkull	81%	17%	2%
Rajoni Jugperëndimor	Femër	92%	0%	8%
	Mashkull	90%	8%	2%


Tabela 23 Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas gjinisë

Pjesa më e madhe (70%) e të diplomuarve që vazhdojnë studimet e mëtejshme zgjedhin institucionet publike dhe vetëm 30% e tyre zgjedhin institucionet private për të vazhduar studimet e mëtejshme. Nuk paraqiten ndryshime të konsiderueshme në përqindje mes rajoneve të ndryshme.



Lidhja mes fushës së studimeve me studimet e mëparshme

Shumica e të diplomuarve që vazhdojnë studime apo trajnime të mëtejshme, 68 % e tyre (N= 272) deklarojnë se fusha e studimeve të tyre aktuale lidhen me studimet e tyre të mëparshme. Ndërkohë që 32% (N=128) e të diplomuarve që vazhdojnë studimet e mëtejshme thonë që fusha e këtyre studimeve nuk lidhet me fushën e studimeve të mëparshme.



Baza e përgjigjeve: N1=272, N2=128
Figura 14 Lidhja e fushës së studimeve me studimet e mëparshme

Po ta shohim lidhjen mes studimeve aktuale dhe atyre të mëparshme të disagreguar sipas rajoneve vërejmë dallime të konsiderueshme mes tyre. Kështu, në Rajonin Jugperëndimor dhe në Rajonin Qendror një përqindje e lartë e të diplomuarve deklarojnë se studimet e tyre aktuale lidhen me studimet e tyre të mëparshme, respektivisht 75% dhe 73 % (N= 46 dhe N= 166) e shprehin këtë dhe vetëm 25% (N=15) dhe 27% (N=62) respektivisht mendojnë se studimet e tyre aktuale nuk lidhen me ato të mëparshme. Ndërkohë 36% (N=18) e të diplomuarve në Rajonin Verior dhe më shumë se gjysma (54 %; N=33) e të diplomuarve në Rajonin Juglindor mendojnë se studimet e tyre aktuale nuk kanë lidhje me ato të mëparshme, çka tregon se ata po studiojnë në një fushë tjetër të ndryshme nga studimet e mëparshme.




Figura 15 Lidhja e fushës së studimeve/trajnimeve me studimet e mëparshme sipas rajoneve

Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimeve

Të diplomuarit u pyetën mbi arsyet më të rëndësishme që i shtynë ata të zgjedhin studimet e mëtejshme. Pjesa më e madhe e të diplomuarve 54% (N=219) ka zgjedhur të vazhdojë studimet e mëtejshme për të arritur një kualifikim më të lartë. Kjo shfaqet si arsye kryesore në të gjitha rajonet por mbizotëron në Rajonin Verior me 60% të të diplomuarve. Ndërkohë që 23% e të diplomuarve (N=91) kanë zgjedhur të ndjekin një tjetër karrierë nga ajo e mëparshme dhe 20% (N = 81) e tyre zgjedhën të vazhdojnë studimet e mëtejshme për të rritur mundësitë e tyre të punësimit. Vetëm 3% (N=13) e të diplomuarve kanë zgjedhur të vazhdojnë studimet sepse nuk arrin të gjenin një punë.





Figura 16 Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimit

Të diplomuarit pa punë

22.9% e të diplomuarve (ose 323 të diplomuar) rezultojnë të papunë dhe duke kërkuar për një punë në momentin që janë pyetur. Rajoni me përqindjen më të lartë të të papunëve në kërkim të një pune është ai Juglindor me 36.9%, ndërsa rajoni me përqindjen më të ulët është ai Qendror me 14.9%.



Baza e përgjigjeve: N1=207, N2=619, N3=336, N4=250, N=1412
Figura 17 Të diplomuar të papunë (në kërkim të një pune) sipas rajoneve

Të kërkuarit për punë

Të diplomuarit e papunë që kanë kërkuar për një punë gjatë 4 javëve para momentit që janë pyetur pohojnë se mënyra më e shpeshtë, që ata kanë përdorur për të gjetur punësim, është nëpërmjet njohjeve familjare dhe miqësore (78.9% pohojnë se kanë zgjedhur këtë mënyrë), lajmërimeve të publikuara në mediumet e ndryshme (55.4%), si dhe duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin (39.4%). Duket se zyrat e punës nuk janë një mënyrë e preferuar për të diplomuarit e papunë në kërkim të një pune, pasi vetëm 13% e tyre pohojnë se kanë kërkuar punësim nëpërmjet zyrave të punës. Në tabelën më poshtë shihet dhe shpërndarja e përgjigjeve sipas rajoneve.

Mënyra e të kërkuarit për punë	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nëpërmjet Zyrës së Punës	9.4%	3.8%	18.3%	22.6%	13.1%
Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.	50.0%	67.3%	41.7%	67.7%	55.4%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	75.0%	78.8%	80.0%	80.6%	78.9%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	28.1%	25.0%	56.7%	41.9%	39.4%

Baza e përgjigjeve: N1=32, N2=52, N3=60, N4=31, N=175.
Tabela 24 Si po kërkon për punë?

Arsyet kryesore për shkak të të cilave, të diplomuarit e papunë nuk kanë kërkuar për një punë gjatë 4 javëve të fundit para pyetësit janë mungesa e dëshirës për të punuar (24.5%), pritja për sezonin e përshtatshëm (21.7%), planet për t'u larguar nga vendi (19.6%) dhe mungesa e besimit për gjetjen e një pune (18.2%). Mungesa e besimit për të gjetur një punë është me e theksuar në Rajonin Verior (25%) dhe atë Juglindor (24.2%), ndërkohë që planet për emigrim janë më të theksuara në Rajonin Qendror (24.2%) dhe atë Juglindor (25.8%).





Arsyeja e të mos kërkuarit për punë	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nga sëmundja ose paaftësia	0.0%	2.6%	0.0%	0.0%	0.7%
Kujdesem për fëmijët/familjen	0.0%	5.3%	0.0%	0.0%	1.4%
Po pres të filloj punë së shpejti	8.3%	7.9%	6.5%	26.3%	9.8%
Po pres për sezonin e përshtatshëm	20.8%	23.7%	21.0%	21.1%	21.7%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	25.0%	23.7%	21.0%	36.8%	24.5%
Nuk kam besim se do gjej një punë	25.0%	5.3%	24.2%	15.8%	18.2%
Kam në plan të largohem nga vendi	12.5%	23.7%	25.8%	0.0%	19.6%
Tjetër	8.3%	7.9%	1.6%	0.0%	4.2%

Baza e përgjigjeve: N1=24, N2=38, N3=62, N4=19, N=143
Tabela 25 Cila është arsyeja që nuk po kërkon për punë?

Marrëdhënia me zyrat e punës




Pjesa dërrmuese e të diplomuarve të papunë në kërkim të një pune (84.7%) pohojnë se nuk janë regjistruar në zyrat e punës për të gjetur një punë. Nuk vihen re dallime domethënëse mes rajoneve.

Ndërkohë pjesa më e madhe e të diplomuarve të papunë që janë regjistruar pranë zyrave të punës (65%) pohojnë se zyra e punës nuk po i ndihmon në gjetjen e një pune, kurse pjesa tjetër (35%) deklaron se zyra e punës po i ndihmon me informacion rreth vendeve të lira të punës, mundësive për trajnim ose me këshilla se si të kërkojnë për punë.




Arsyeja kryesore pse pjesa tjetër e të diplomuarve të papunë nuk është regjistruar në zyrat e punës është mungesa e interesit (47,2%), ndjekur nga mungesa e besimit se zyrat e punës mund t'i ndihmojnë në gjetjen e punës (28.8%) dhe mungesa e njohurive për t'u regjistruar (22.9%).


Në Rajonin Juglindor dhe atë Jugperëndimor shihet më e theksuar mungesa e interesit me përkatësisht 58.9% dhe 51.4% të painteresuar, ndërkohë që mungesa e besimit shihet të jetë thuajse në të njëjtin nivel në të gjitha rajonet. Përqindje të larta të të diplomuarve të papunë që nuk janë informuar rreth procesit të regjistrimit në zyrat e punës shihen në rajonin Qendror dhe atë Verior.




Pjesa më e madhe (rreth 60%) e të diplomuarve të papunë që kanë punuar më parë e ka gjetur punën para se të diplomoheshin, rreth 35% e kanë gjetur punën deri në 3 muaj pas diplomimit, kurse pjesa e mbetur (rreth 5%) e kanë gjetur punën më vonë se 3 muaj pas diplomimit.




Të diplomuarit e papunë që kanë punuar më parë janë pyetur më tej rreth mënyrës se si e kanë gjetur punën. Tre mënyrat më të përdorura për të gjetur punë janë: njohjet, lidhjet familjare dhe miqësore me 61.7%, kontakti i drejtpërdrejtë me punëdhënësin me 25.8% dhe praktika profesionale në biznes me 8.6%. Nuk vihen re dallime domethënëse mes rajoneve.



Megjithëse pjesa më e madhe e të papunëve që kanë punuar më parë e kanë gjetur shpejt punën e tyre, ata nuk kanë mundur të qëndrojnë të punësuar gjatë pas diplomimit. Siç tregohet në grafikun 12, rreth 1 nga 2 të papunë të punësuar më parë është larguar nga puna 3-6 muaj para momentit që është pyetur, kurse rreth 1 në 3 është larguar 1-3 muaj para këtij momenti.




Dy arsyet mbizotëruese që kanë ndikuar për humbjen e vendit të punës të të diplomuarve që po kërkojnë për punë janë ato personale (49.6%) dhe shkurtime në vendin e punës (36.8%). Edhe në këtë rast nuk vihen re dallime domethënëse mes rajoneve.



Të diplomuar joaktivë

Prej 1412 të diplomuarish të anketuar vetëm 95 prej tyre (7%) nuk janë në punë, nuk vazhdojnë studimet e mëtejshme dhe nuk janë në kërkim të një pune të paktën 4 javët e fundit. Të pyetur për arsyet se përse nuk po kërkojnë për punë, rreth 35% (N=33) e të diplomuarve përgjigjen se kanë në plan të largohen nga Shqipëria dhe 34% e tyre (N=32) përgjigjen se nuk kanë dëshirë të punojnë për momentin. Rreth 15% e të diplomuarve (N=15) që nuk po kërkojnë për punë shprehen se janë në pritje për të filluar punë së shpejti ose po presin sezonin e përshtatshëm për të kërkuar/filluar punë. Një numër më i vogël tyre (vetëm 7 të diplomuar) shprehen se nuk kanë besim se do të gjejnë një punë dhe 5 prej tyre nuk po kërkojnë një punë për shkak se po kujdesen për fëmijët/familjarët.



Në tabelën më poshtë mund të shohim një disagregim sipas rajoneve të arsyeve kryesore të shprehur nga të diplomuarit se përse nuk po kërkojnë për punë. Në Rajonin Verior mbizotërojnë dy arsye kryesore, mungesa e dëshirës për të punuar në këtë moment dhe planet për të migruar në të ardhmen e afërt me nga 36% të të diplomuarve respektivisht. Në Rajonin Qendror dhe atë Jugperëndimor duket se planet për t'u larguar nga vend janë arsyet mbizotëruese përse të diplomuarit në këtë rajon nuk po kërkojnë punë për momentin (45% dhe 44% respektivisht). Në Rajonin Juglindor rreth 55% e të diplomuarve shprehen se nuk po kërkojnë një punë pasi nuk kanë dëshirë të punojnë për momentin ndërkohë, ndryshe nga rajonet e tjera, planet për t'u larguar nga vendi shprehen vetëm nga 10% të të diplomuarve.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nga sëmundja ose paaftësia	4%	7%	0.0%	0.0%	3%
Kujdesem për fëmijët/familjen	11%	7%	0.0%	0.0%	5%
Po pres të filloj punë së shpejti	4%	10%	5%	11%	7%
Po pres për sezonin e përshtatshëm	11%	7%	10%	6%	8%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	36%	21%	55%	28%	34%
Nuk kam besim se do gjej një punë	0.0%	3%	20%	11%	7%
Kam në plan të largohem nga vendi	36%	45%	10%	44%	35%

Tabela 26 Arsytet kryesore se përse nuk po kërkon për punë sipas rajoneve

VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË DIPLOMUARVE PËR SHKOLLËN

Në këtë seksion prezantohen gjetjet kryesore të vlerësimit retrospektiv të të diplomuarve nga arsimi profesional për institucionin ku kanë ndjekur studimet. 83.4% e të diplomuarve do të zgjidhnin sërish të njëjtën shkollë nëse do të kishin mundësi dhe ky perceptim nuk shfaq dallime të konsiderueshme në varësi të rajonit të të diplomuarit apo gjinisë. 83% e meshkujve dhe 86.2% e femrave do të zgjidhnin të njëjtën shkollë.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Po	86.1%	82.6%	83%	83.4%	83.4%
Jo	13.9%	17.4%	17%	16.6%	16.6%

Baza e përgjigjeve: N1=201, N2=582, N3=330, N4=229.
Tabela 27 Nëse do kishe mundësi a do të zgjidhje të njëjtën shkollë?




Figura 28 Nëse do kishe mundësi a do të zgjidhje të njëjtën shkollë (sipas gjinisë)

Të pyetur nëse do të zgjidhnin të njëjtin drejtim, në të njëjtën linjë, 83% e të diplomuarve do të zgjidhnin të njëjtin drejtim. Për këtë pyetje, nuk shfaqen dallime në nivel rajonesh, por kishte dallime në varësi të drejtimit profesional të të diplomuarve. Të diplomuarit e drejtimit Mekanikë (87.4%) dhe të diplomuarit e drejtimit Hoteleri-Turizëm (86.3%) ishin më të prirur për të deklaruar se do të zgjidhnin të njëjtin drejtim përkundrejt drejtimeve të tjera.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Po	81.1%	81.5%	84.2%	86.9%	83%
Jo	18.9%	18.5%	15.8%	13.1%	17%

Baza e përgjigjeve: N1=201, N2=583, N3=329, N4=229.
Tabela 28 Nëse do kishe mundësi a do të zgjidhje të njëjtën degë/drejtim?




Figura 29 Nëse do kishe mundësi a do të zgjidhje të njëjtën degë/drejtim ('Po' sipas drejtimeve)

Në pyetësor u përfshinë gjithashtu disa kategori pyetjesh në lidhje me nevojën për përmirësime të aspekteve të ndryshme si infrastruktura, kurrikulat, mësimdhënia, tekstet mësimore, aftësia teorike, praktika, puna në zyrën e karrierës, bashkëpunimi me biznesin etj. Pyetjet u formuluan në mënyrë të tillë që të ishin sa më të kuptueshme nga intervistuesi dhe i anketuari duke zgjedhur përgjigjen nëpërmjet alternativave të parashikuara në pyetësor të cilat ishin të shkallëzuara sipas shkallës Likert. Gjatë fazës së përpunimit të dhënave të intervistuarve u grupuan në 3 shkallë: a) aspak ose pak; b) mesatarisht si dhe c) shumë. Më poshtë janë rezultatet për kategorinë 'fusha ka nevojë për shumë përmirësim'.

Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës vlerësohen se kanë nevojë për shumë përmirësim nga 46.9% e të gjithë të diplomuarve të anketuar, ndërsa metodat e mësimdhënies nga 42.7%. 31.7% mendonin që kurrikulat kanë nevojë për shumë përmirësim dhe tekstet dhe materialet mësimore në masën 35.4%. 4 në 10 të diplomuar (40.5%) vlerësonin se infrastruktura në shkollë kishte nevojë për shumë përmirësim. Ndarja sipas rajoneve tregon që përgjatë gjithë aspekteve të vlerësuara, të diplomuarit e Rajonit Qendror ishin më të prirur për të vlerësuar më dobët.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Infrastruktura	26.7%	53.9%	35.8%	25.5%	40.5%
Kurrikulat	17.8%	41.5%	27.8%	24.3%	31.7%
Tekstet dhe materialet	26.7%	46.3%	30.8%	22.1%	35.4%
Metodat e mësimdhënies	34.3%	56.1%	32.5%	30.3%	42.7%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	39%	62.1%	34.8%	32.5%	46.9%


Tabela 29 Fushat që kanë nevojë për 'shumë' përmirësim

Ndërkohë, praktika në shkollë dhe praktika profesionale në biznes vlerësohet se ka nevojë për shumë përmirësim nga 45.7% dhe 43.3% e të diplomuarve. 44.5% mendojnë se këshillimi i karrierës duhet të përmirësohet në një shkallë të konsiderueshme. Sërish, ndarja sipas rajoneve tregon që përgjatë këtyre aspekteve të vlerësuara, të diplomuarit e Rajonit Qendror ishin më të prirur për të perceptuar se shkollat e tyre kishin nevojë për shumë përmirësim.

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Praktika në shkollë	38.6%	55.7%	42.6%	30.7%	45.7%
Praktika në biznes	32.8%	50.2%	44.6%	33.3%	43.3%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	22.2%	42.4%	38.1%	27.8%	35.9%
Bashkëpunimi i shkollës me zyrat e punës	20.6%	37.3%	37.8%	25.2%	32.9%
Këshillimi i karrierës	32.8%	56.1%	39.1%	32.9%	44.5%

Tabela 29 Fushat që kanë nevojë për 'shumë' përmirësim

Të pyetur rreth pritshmërive të tyre për 2 vitet e ardhshme, në 17.9% të rasteve të diplomuarit dëshironin të ishin të punësuar pavarësisht profilit, ndërsa 36.8% të ishin të punësuar në një punë që lidhej me fushën e tyre të studimeve. Në 24.6% të rasteve, ata planifikonin të hapnin një biznes, ndërsa 36.5% të emigronte jashtë vendit.





TË DIPLOMUARIT NGA ARSIMI PROFESIONAL

2019-2020: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Le të mbetemi në kontakt!

 www.aftesiperpune.al

 [@S4J.Swisscontact](https://www.facebook.com/S4J.Swisscontact)

 [skills_for_jobs](https://www.instagram.com/skills_for_jobs)

 [Skills for Jobs Albania](https://www.linkedin.com/company/skills-for-jobs-albania)

 [Aftësi për Punë S4J](https://www.youtube.com/Aftesi_per_Pune_S4J)

Regjistrohuni te buletini ynë: al.info@swisscontact.org